



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

**PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të zyrtarëve dhe të institucioneve publike si dhe garantimi i kryerjes së funksioneve publike nga ana e zyrtarëve në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në interesin më të mirë të mundshëm të publikut dhe të besimit të tij ndaj institucioneve publike nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave publike dhe atyre private të zyrtarëve.

**Neni 2
Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave lidhur me veprimet dhe veprimtaritë e zyrtarëve gjatë kryerjes së funksioneve publike, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe privat të zyrtarit gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit publik, si dhe masat për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.

**Neni 3
Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Institucion publik”** për qëllim të këtij ligji do të kuptohet çdo institucion shtetëror, qendror ose vendor, si dhe çdo njësi apo subjekt i krijuar ose në varësi të tyre, përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror ose vendor, organizatat jo-fitimprurëse dhe personat e tjerë juridikë, të zotëruar nga institucionet qendrore ose vendore apo organet dhe subjektet e krijuara dhe/ose në varësi të tyre në masën që ato kryejnë funksione publike, si dhe çdo organ publik sipas parashikimeve ligjore në fuqi, e që rregullohet nga regjimi i së drejtës publike.
2. **“Konflikt i interesit”** është situata e një konflikti ndërmjet detyrave publike dhe interesave private të një zyrtari ose personi të lidhur me zyrtarin që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen objektive dhe të paanshme të detyrave dhe funksioneve të tij publike.
3. **“Zyrtar publik”** është çdo person i përcaktuar në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunës publikë, që përfshihet në kategorinë e subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe çdo zyrtar tjetër i punësuar, i zgjedhur ose i emëruar, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme në një institucion publik, i ngarkuar për të ushtruar funksione apo detyra publike, e që deklaron pranë njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave.
4. **“Persona të lidhur me zyrtarin publik”** janë bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, birësuesi, i birësuar, krushqia e afërt vjehërr/a, dhëndër, nuse, vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, thjeshtë, njerë e njerë, si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.
5. **“Person i besuar”** është personi fizik ose juridik që ushtron në mënyrë të pavarur të drejtat e administrimit të shoqërisë tregtare apo të drejta të tjera të përcaktuara me marrëveshje të lidhur me zyrtarin, për aksionet ose pjesët në kapital të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga zyrtari. Personi i besuar nuk mund të jetë nga rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, ose një zyrtar apo person tjetër me lidhje varësie, qoftë edhe të tërthortë, për shkak të funksionit publik me zyrtarin, si dhe një organizatë jofitimprurëse ose një shoqëri ku zyrtari zotëron pjesë në kapital ose aksione, apo ka pasur ose ka marrëdhënie interesi të çfarëdo lloji.
6. **“Personi përgjegjës i shoqërisë”** është subjekti i cili në bazë të legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, drejton shoqërinë në të cilën zyrtari dhe personat e lidhur me të zotërojnë në mënyrë aktive ose të tërthortë aksione apo pjesë në kapital.
7. **“Zotërimi aktiv” dhe “zotërim i tërthortë i aksioneve ose pjesëve në kapital”** kanë të njëjtin kuptim sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në fuqi.
8. **“Dhuratë”** është një e mirë, send, e drejtë apo shërbim, fituar pa kundërshtpërblim, apo për shkak të trajtimit preferencial dhe çdo përfitim tjetër që i ofrohet zyrtarit ose një personi të lidhur me zyrtarin, përkundrajt ushtrimit të funksionit të tij.
9. **“Vendimarrje”** është procesi gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit dhe ose kontratës administrative, si dhe fazat paraprake të këtij procesi në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të tyre. Në këtë kuptim do të vlerësohet edhe pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit në procesin që kalon një vendimarrje, kur ka prani të interesave private.

10. **“ILDKPKI”** është Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave.
11. **“Regjistri i zyrtarëve publikë”** është një regjistër i veçantë ku evidentohen zyrtarët publikë, me qëllim verifikimin, kontrollin dhe hetimin administrativ, për efekt të parandalimit të konfliktit të interesave, që administrohet, përditësohet dhe mirëmbahet nga ILDKPKI.
12. **“Tregtari”** ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në fuqi.
13. **“Epror i një zyrtari”** është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi zyrtarin, sipas legjislacionit në fuqi.
14. **“Institucion epror”** është institucioni publik ose organ i tij që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik ose organ të tij, ku, në këtë të fundit, zyrtari kryen funksionet, detyrat dhe ushtron kompetencat e tij.
15. **“Shoqëritë”** përfshin të gjitha format e organizimit në shoqëri tregtare si dhe format e thjeshta të organizimit sipas Kodit Civil.
16. **“Organizatë jo fitimprurëse”** ka të njëjtin kuptim si në ligjin për organizatat jofitimprurëse.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të zbatueshme për:

- a) çdo zyrtar publik, që ushtron detyra, funksione e kompetenca të caktuara, në një institucion publik sipas kuptimit të këtij ligji;
- b) çdo zyrtar publik, që merr pjesë në vendimmarrje për akte administrative, kontrata administrative dhe çdo veprim tjetër administrativ, akte të organeve gjyqësore, të prokurorisë, akte noteriale, ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe akte normative;
- c) çdo institucion publik;
- ç) personat e lidhur me zyrtarin publik në mënyrën dhe masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 5

Format e konfliktit të interesit

Konflikti i interesit shfaqet në këto forma:

- a) **“Konflikt rast për rast i interesit”** është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të kundraligjshme të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare, për shkak, dhe vetëm, të ndikimit të mundshëm të interesave private të tij, i cili shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.

- b) “Konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shfaqen në vendimmarrje në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.
- c) “Konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja në të cilën zyrtarit, për shkak të funksionit publik, i kufizohet posedimi i interesave private, ndalimi për të kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe ndalimi të fitojë pasuri publike prej saj, përfitime financiare dhe dhurata, sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

Neni 6

Interesi privat

1. Interesi privat i zyrtarit publik përfshin përfitimin material ose jomaterial në dobi të tij ose të personave të lidhur me të, me të cilët ai ka marrëdhënie personale, pune ose politike, duke përfshirë:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore ose trajtime preferenciale;
- ç) marrëdhënie familjare apo çdo marrëdhënie tjetër me palë të tretë që mund të ndikojë në ushtrimin e detyrës;
- d) negocime të mundshme për punësim apo çdo lloj marrëdhënie tjetër me interes privat për zyrtarin, gjatë dhe pas përfundimit të detyrës prej tij;
- dh) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- e) çdo interes tjetër privat që shkakton konflikt interesi, siç përcaktohet në këtë ligj.

2. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo interes privat i zyrtarit publik të përcaktuar në këtë nen, çdo lidhje apo ndërthurje e tyre, që përbën konflikt interesi, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KREU II

PARIMET E KUFIZIMIT TË INTERESAVE PRIVATE DHE PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË SUBJEKTEVE TË LIGJIT

Neni 7

Parimi i ligjshmërisë

Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesit bazohet në respektimin e ligjit, garantimin që çdo masë apo veprim i ndërmarrë nga zyrtarët ose institucionet publike të mbështetet në dispozita të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme, duke garantuar sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit për të gjithë zyrtarët publikë.

Neni 8

Parimi i integritetit

Zyrtari ushtron funksionin e tij me ndershmëri, paanësi dhe në përputhje me interesin publik, duke shmangur çdo ndikim nga interesat private që cenojnë besimin e publikut dhe integritetin e vendimmarrjes.

Neni 9

Parimi i paanësisë dhe objektivitetit

Zyrtari ushtron funksionin e tij në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke u bazuar në vlerësimin e fakteve dhe në zbatimin e ligjit, pa u ndikuar nga interesa private, bindje politike apo çdo formë tjetër ndikimi të papërshtatshëm.

Neni 10

Parimi i proporcionalitetit

Masat për parandalimin e konfliktit të interesave duhet të jenë në proporcion me rëndësinë e detyrave, përgjegjësiave dhe kompetencave të zyrtarit ose institucionit publik përkatës. Në realizimin e funksionit të saj, ILDKPKI dhe njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, kryen hetimin administrativ vetëm për aq sa është e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të parandalimit të konfliktit të interesit.

Neni 11

Parimi i transparencës

Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesave bazohet në transparencën e veprimtarisë së zyrtarëve dhe të institucioneve publike, përmes dokumentimit të vendimmarrjes, qartësisë së procedurave dhe aksesit të publikut në informacion, me qëllim forcimin e besimit në institucionet publike dhe nxitjen e llogaridhënies.

Neni 12

Parimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes

Kufizimet e interesave private, të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligjet e tjera, zbatohen në mënyrë të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë zyrtarët e institucioneve publike, në përputhje me detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre.

Neni 13

Parimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit

Trajtimi dhe zgjidhja e rasteve të konfliktit të interesave bëhet në bazë të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet zyrtarit dhe eprorit ose institucionit epror, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen sa më të shpejtë dhe efektive të situatave që lindin nga prania e interesave private.

Neni 14
Parimi i përgjegjësisë personale

Zyrtari është përgjegjës për parandalimin dhe zgjidhjen e çdo situatë të konfliktit të interesit që lidhet me të, si dhe për interesat private të personave të lidhur, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 15
Parimi i parandalimit mbi ndëshkimin

Parandalimi i konfliktit të interesave përbën qëllim parësor të këtij ligji dhe realizohet përmes marrjes së masave të qarta dhe të zbatueshme nga zyrtarët dhe institucionet publike, përpara zbatimit të masave ndëshkuese të parashikuara në këtë ligj.

Neni 16
Parimi i zbatimit të kufizimit më të rreptë

1. Kur për të njëjtin interes privat të zyrtarit parashikohen kufizime në këtë ligj dhe në një ligj tjetër, zbatohet ajo dispozitë që vendos kufizimin më të rreptë.
2. Nëse për një interes të caktuar privat të zyrtarit nuk parashikohet kufi sasior në këtë ligj, por ai përcaktohet në një ligj tjetër, ky kufi sasior zbatohet edhe për efekt të këtij ligji, dhe anasjelltas.

KREU III

DETYRIMET E ZYRTARËVE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 17
Përgjegjësia për parandalimin e konfliktit të interesit

1. Zyrtari publik, nga momenti i zgjedhjes ose emërimit të tij dhe gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit publik, ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë çdo situatë të konfliktit të tij të interesit, në mënyrë të menjëhershme dhe efektive.
2. Kur zyrtari publik ka dyshime për ekzistencën e një konflikti interesi, ai duhet të informojë pa vonesë eprorin ose institucionin përkatës, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për parandalimin ose zgjidhjen e tij.
3. Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Neni 18
Përgjegjësia e zyrtarit për interesat private të personave të lidhur

Zyrtari publik, nga momenti i zgjedhjes ose emërimit dhe gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit publik, ka detyrimin të parandalojë dhe të zgjidhë çdo situatë të konfliktit të interesit që lidhet me të, përfshirë edhe rastet kur kjo situatë lind nga interesat private të personave të lidhur apo të personave të besuar. Këto interesa vlerësohen njëllësi si të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit, i cili ka detyrimin t'i parandalojë dhe të zgjidhë menjëherë dhe në mënyrë efektive çdo situatë të konfliktit të interesit që lind prej tyre.

Neni 19

Kufizimi dhe ndalimi i zotërimit të tërthortë të interesave

1. Kufizimet dhe ndalimet e parashikuara në këtë ligj zbatohen edhe kur zyrtari zotëron, në mënyrë të tërthortë, aksione ose pjesë në kapitalin e një shoqëri tregtare, ortakërie ose shoqërie të thjeshtë, e cila zotëron aksione apo pjesë në kapitalin e një shoqërie tregtare, ortakërie ose shoqërie të thjeshtë, kur kjo e fundit është palë në një marrëdhënie kontraktore me institucionin publik përkatës.
2. Kufizimet dhe ndalimet e parashikuara në këtë ligj zbatohen edhe kur zyrtari zotëron interesa të lidhura me persona fizikë ose juridikë, të regjistruar jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë, të cilët zotërojnë ose kontrollojnë një person juridik, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Në këto raste, kufizimet zbatohen në atë masë që marrëdhënia e tërthortë i mundëson zyrtarit të ushtrojë ndikim ose të përfitojë në mënyrë të barasvlershme me zotërimin e drejtpërdrejtë.

Neni 20

Barra e provës

Kur nga të dhënat e mbledhura nga procedimi administrativ ose nga burime të tjera të ligjshme, provohet ekzistenca e interesave private të zyrtarit që mund të krijojnë një situatë konflikti interesi për shkak të kufizimeve dhe ndalimeve të përcaktuara në këtë ligj, zyrtari ka detyrimin të paraqesë prova ose shpjegime të arsyetuara për të provuar të kundërtën.

KREU IV

DEKLARIMI I KONFLIKTIT TE INTERESAVE

Neni 21

Deklarimi i interesave privatë

1. Zyrtari publik, nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës, është i detyruar të plotësojë dhe të dorëzojë formularin e deklaratimit të interesave privatë në të cilin do të deklarojë të gjitha interesat privatë për vete dhe personat e lidhur me të, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Deklarimi Periodik i interesave privatë dorëzohet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së apo pranë njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave.

2. Përmbajtja e formularit të deklaramit të interesave private dhe autorizimit për zyrtarët publikë përgatitet dhe publikohet nga ILDKPKI dhe është në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Formularët e deklaramit elektronik për të gjitha rastet e mundshme të deklaramit të konfliktit të interesit sigurohen përmes Platformës online për Deklarimin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit. Autoritetet publike mbledhin të dhëna personale pa barrë administrative të shtuar për zyrtarët publikë që të japin “autorizime të veçanta”.

Neni 22

Deklarimi i ndryshimeve të interesave privatë

1. Çdo zyrtar publik gjatë periudhës të kryerjes së funksionit publik, me lindjen ose ndryshimin e interesave private të tij dhe personave të lidhur me të, është i detyruar të plotësojë formularin e deklaramit të ndryshimeve të interesave private.
2. Formulari i deklaramit të ndryshimeve të interesave privatë duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve nga data e ndryshimeve të interesave private, pranë ILDKPKI-së apo njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 23

Deklarimi rast pas rasti i interesave private

1. Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, kryen vetëdeklarim paraprak, të interesave të tij private, kur përfshihet në vendimmarrje që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
2. Deklarimi i interesave private bëhet nga zyrtari, sa herë që kërkohet nga eprori direkt, titullari i institucionit, institucioni epror ose ILDKPKI. Deklarimi, si rregull, kërkohet dhe kryhet paraprakisht. Nëse kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet të bëhet sa më shpejt, por jo më vonë se 7 ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një çështje të caktuar.
4. Në çdo rast të shfaqjes së konfliktit të interesit, autoriteti përgjegjës në institucionin punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkakun për konfliktin e interesit dhe konfliktin e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informacionit, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Neni 24

Autorizimi i kontrollit

1. Deklarimi i interesave private shoqërohet me një autorizim të veçantë që zyrtari dhe personi i lidhur me të duhet të lëshojë në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion dhe/ose ILDKPKI të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna personale për zyrtarin dhe personin e lidhur me të. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

2. Mosdhënia e autorizimit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklarimin e interesave private përbën shkak ligjor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas legjislacionit përkatës.

KREU V

PAPAJTUESHMËRITË E FUNKSIONEVE TË ZYRTARËVE

Neni 25

Kufizime të përgjithshme

1. Llojet dhe kufizimet e interesave privatë të kategorive të zyrtarëve, të përcaktuara në këtë kre, nuk përjashtojnë llojet dhe kufizimet e përcaktuara në ligje të tjera për këto kategori zyrtarësh, të zbatuara për të njëjtin qëllim, por në çdo rast zbatohet dispozita që përcakton kufizimin më të rreptë.
2. Kur në ligje të veçanta përcaktohet se zyrtarët publikë nuk mund të kryejnë veprimtari private, kjo nënkupton edhe ndalimin e zotërimit në mënyrë aktive apo dhe të tërthortë të aksioneve ose pjesëve në kapital në shoqëritë tregtare në atë masë për të cilat ndalohet kjo veprimtari.
3. Në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur, ato vlerësohen njëjloj si të jenë të regjistruara në emër të vetë zyrtarit. Personit të lidhur i kufizohen të drejtat pasurore, në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit, sipas kufizimeve dhe ndalimeve të vendosura në këtë ligj. Këto kufizime nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin.

Neni 26

Kufizime për deputetin

1. Gjatë ushtrimit të mandatit, deputetit nuk i lejohet:
 - a) të ushtrojë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave;
 - b) të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të përfitojë pasuri pres saj;
 - c) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse; ç të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e tregtarit, shoqërisë tregtare, apo të çdo forme tjetër;
 - d) të jetë i punësuar në një detyrë tjetër;
 - dh) të zotërojë, në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare të çdo forme.

Neni 27

Kufizime për anëtarin e Këshillit të Ministrave dhe Zëvendësministrin

1. Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri nuk mund të:

a) jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese në organizata jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, me përjashtim të organizatave politike dhe/ose shtetërore, si dhe në rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;

b) ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e tregtarit, shoqërisë tregtare të çdo forme dhe nuk mund të jetë i punësuar në një detyrë tjetër;

c) zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Neni 28

Kufizime për zyrtarë në funksione të larta kushtetuese dhe ligjore

1. Presidenti i Republikës, Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Strukturës së Posaçme Antikorrupsion (SPAK), Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, Avokati i Popullit, anëtar i organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk mund të:

a) jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse;

b) ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e tregtarit, shoqërisë tregtare të çdo forme dhe nuk mund të jetë i punësuar në një detyrë tjetër;

c) zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare të çdo forme.

Neni 29

Kufizime për gjyqtarët dhe prokurorët

1. Gjyqtari dhe prokurori, gjatë ushtrimit të funksionit, nuk mund të:

a) jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse;

b) administrojë, të dretojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit;

c) ushtrojë veprimtari fitimprurëse si person fizik tregtar ose si pjesëtar në një shoqëri tregtare, të çdo forme;

ç) zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, të çdo forme;

d) zotërojë në mënyrë të tërthortë aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare të çdo forme, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike;

dh) zotërojë në mënyrë të tërthortë aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e tij, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar;

- e) ushtrojë veprimtari profesionale si avokat, noter, ekspert i licencuar, konsulent, agjent, përfaqësues i subjekteve private, si dhe të ushtrojë funksione si ekspert në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar;
- ë) jetë i punësuar në një detyrë tjetër ose të ushtrojë veprimtari publike ose private, përveç mësimdhënies;

2. Kufizimet sipas pikës 1 të këtij neni zbatohen edhe për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë periudhës së ndjekjes së Shkollës së Magjistraturës, si dhe për magistratët në pritje të emërimit në detyrë.

Neni 30

Kufizime për kryetarin e bashkisë dhe kryetarin e këshillit të qarkut

1. Kryetari i bashkisë dhe kryetari i këshillit të qarkut nuk mund të:

- a) jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese në organizata jofitimprurëse, sindikata apo organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe/ose shtetërore ose kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;
- b) ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e tregtarit, shoqërisë tregtare të çdo forme dhe nuk mund të jetë i punësuar në një detyrë tjetër;
- c) zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare që ushtron veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tyre.

Neni 31

Kufizime për anëtarin e organit të autoritetit rregullator

1. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj, anëtarin e kryetari i një enti apo të një autoriteti rregullator, anëtarin dhe kryetari i Autoritetit të Mbrojtjes së Konkurrencës, anëtarin dhe kryetari i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare nuk mund të:

- a) jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse;
- b) ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e tregtarit, shoqërisë tregtare të çdo forme dhe nuk mund të jetë i punësuar në një detyrë tjetër;
- c) zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare të çdo forme.

Neni 32

Kufizime për zyrtarin e administratës tatimore ose doganore

1. Përveç kufizimeve të përcaktuara në nenin 33 pika 1 të këtij ligji, për zyrtarin e administratës doganore dhe tatimore, që merret me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore zbatohen edhe kufizimet e mëposhtme:

- a) zyrtari i organit doganor nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë të kapitalit në shoqëritë tregtare, që kryejnë veprimtari import-eksporti;

b) zyrtari i organit tatimor nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, të cilat janë tatimpagues ose ushtrojnë veprimtari në fushën ose territorin e juridiksionit të degës së tatim-taksave, ku ushtron funksionet ky zyrtar.

Për zyrtarët e organit drejtues qendror, territor i juridiksionit konsideroheti gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Përcaktimi i kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore dhe doganore që i nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në këtë nen bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

Neni 33

Kufizime për zyrtarë të tjerë

1. Përveç sa parashikuar në nenin 32 të këtij ligji, zyrtarët publikë të cilët nuk përfshihen në nenet pararendëse të këtij kreu nuk mund të:

a) ushtrojnë veprimtari profesionale për të cilat kërkohet licensim sipas legjislacionit në fuqi, si avokatia, noteria, përmbarimi gjyqësor publik ose privat, administrimi i falimentimit, eksperti i licencuar, si dhe nuk mund të jenë të punësuar në një detyrë tjetër, përveç rastit kur këto pozicione mbahen për shkak të detyrës së zyrtarit ose përfaqësimit të institucionit publik ku ai ushtron detyrën, sipas parashikimeve në legjislacionin përkatës;

b) jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të një shoqërie tregtare ose organizate jofitimprurëse, nëse aktiviteti i tyre bie në fushën e juridiksionit ose të kompetencës të zyrtarit për të vepruar, përveç rastit kur këto pozicione mbahen për shkak të detyrës së zyrtarit ose përfaqësimit të institucionit publik ku ai ushtron detyrën, sipas parashikimeve në legjislacionin përkatës;

c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private që krijon të ardhura si person fizik tregtar ose si ortak në një shoqëri tregtare të çdo forme, nëse kjo veprimtari përputhet ose bie në sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar;

ç) zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapitalin e një shoqërie tregtare, nëse kjo shoqëri ushtron veprimtari që përputhet ose bie në sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar.

2. Për zyrtarin e njësisë së qeverisjes vendore, shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni zbatohen vetëm kur veprimtaria e subjekteve të përmendura në to ushtrohet në territorin e juridiksionit të tij.

Neni 34

Kufizimi i interesave private të personave të lidhur

1. Personi i lidhur me zyrtarin publik nuk mund të ushtrojë veprimtari si tregtar apo shoqëri tregtare të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose bie në fushën e juridiksionit dhe të kompetencës së tij për të vepruar me akte individuale apo normative të nxjerra prej tij, ose kur zyrtari luan rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto për këtë tregtar apo shoqëri tregtare, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur.

2. Ndalimi i parashikuar në pikën 1 nuk zbatohet kur mjete i vetëm, me të cilin zyrtari mund të krijojë efektet e mësipërme, është një ligj, një vendim i këshillit të bashkisë, këshillit të qarkut ose një vendim gjyqësor.

Neni 35

Kufizimet e zyrtarit pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik

1. Pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, zyrtari publik që deklaron pranë ILDKPKI-së nuk mund të:

a) punësohet për një periudhë deri në dy vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë drejtuese ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve të varësisë së tyre, të cilat kanë marrëdhënie me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo auditimin e aktivitetit të tyre;

b) përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të lidhur ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në 1 vit pas përfundimit të funksionit publik;

c) përfaqësojë persona fizikë ose juridik, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi të lidhur ose të besuar, në një mosmarrëveshje ose marrëdhënie me institucionin, që lidhet me detyrën që ai ka kryer deri në 1 vit pas përfundimit të funksionit publik;

2. Me mbarimin e funksionit të zyrtarit publik, institucioni në të cilin ky zyrtar ka ushtruar funksionin, nuk mund të ketë marrëdhënie kontraktore brenda 1 viti me tregtarin apo shoqërinë tregtare në të cilin ish-zyrtari, personi i lidhur me të apo personi i besuar, kanë pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kapital apo në organet drejtuese të tij.

3. Institucioni publik në të cilin zyrtari ka ushtruar funksionin publik duhet që, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, t'i kërkojë subjektit zgjidhjen e kontratës apo revokimin e përfaqësimit, si dhe të njoftojë ILDKPKI për rrethanat e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

KREU VI

KUFIZIME DHE NDALIME TË INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR ÇESHTJE TË VEÇANTA

Neni 36

Kufizimi dhe ndalimi për të përfituar nga prona publike

1. Presidenti i Republikës, deputeti, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministri, zëvendësministri, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetari i Gjykatës Larte, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Drejtuesi i Strukturës së Posaçme Antikorrupsion (SPAK), Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe çdo shoqëri tregtare apo shoqëri e thjeshtë, ku zyrtari zotëron, në mënyrë aktive apo të tërthortë, aksione a pjesë në kapital, pavarësisht nga përqindja e zotërimit, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të fitojë pasuri prej saj.

2. Gjyqtari dhe prokurori dhe çdo shoqëri tregtare apo shoqëri e thjeshtë, ku ai zotëron, në mënyrë aktive apo të tërthortë, aksione a pjesë në kapital, pavarësisht nga përqindja e zotërimit, nuk mund të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të fitojë pasuri prej saj, në fushën e juridiksionit territorial, ku ushtron funksionin gjyqtari ose prokurori.

3. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj, anëtari i një enti apo të një autoriteti rregullator, anëtari dhe kryetari i Autoritetit të Mbrojtjes së Konkurrencës, anëtari dhe kryetari i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe çdo, shoqëri tregtare apo shoqëri e thjeshtë ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo të tërthortë, aksione a pjesë në kapital, pavarësisht nga përqindja e zotërimit, nuk mund të kryejë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të fitojnë pasuri prej saj, në fushën e juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari.

4. Zyrtari i administratës doganore dhe tatimore, si dhe çdo shoqëri tregtare apo shoqëri e thjeshtë, në të cilën ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo të tërthortë, aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga përqindja e zotërimit, nuk mund të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të fitojë pasuri prej saj, brenda juridiksionit të institucionit ku zyrtari ushtron funksionin.

5. Zyrtari në funksionin e kryetarit ose të zëvendëskryetarit të bashkisë, të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit të bashkisë apo qarkut, si dhe çdo shoqëri tregtare apo shoqëri e thjeshtë, në të cilën ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo të tërthortë, aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga përqindja e zotërimit, nuk mund të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të fitojë pasuri prej saj. brenda juridiksionit të bashkisë ose të këshillit të qarkut ku zyrtari ushtron funksionin.

6. Zyrtarët publikë të papërmendur në pikat e mësipërme të këtij neni, si dhe çdo shoqëri tregtare apo shoqëri e thjeshtë, në të cilën ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo të tërthortë, aksione ose pjesë në kapital, pavarësisht nga përqindja e zotërimit, nuk mund të kryejnë veprimtari fitimprurëse që buron nga prona publike dhe as të përfitojnë pasuri prej saj, brenda juridiksionit të institucionit ku zyrtari ushtron funksionin. Ky ndalim zbatohet edhe kur pala përfituese apo kontraktuese është një institucion i varësisë.

7. Ndalimet dhe kufizimet e parashikuara në pikat e mësipërme të këtij neni zbatohen edhe për personat e lidhur me zyrtarin. Ndalimet dhe kufizimet e këtij neni nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin.

8. Ndalimet dhe kufizimet e parashikuara në pikat e mësipërme të këtij neni nuk zbatohen kur parashikohet ndryshe në ligje të veçanta, për realizimin e qëllimeve publike ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve.

Neni 37

Kufizime dhe ndalime në sigurimin e të ardhurave nga zyrtarët publikë

1. Zyrtarit publik i ndalohet që të zotërojë në mënyrë aktive, aksione, pjesë në kapital ose përfitime të tjera që nuk rrjedhin nga zotërimi i tërthortë, në shoqëri tregtare që përfitojnë përjashtime apo lehtësime nga detyrimet doganore ose tatimore, ose që ushtrojnë veprimtari në zona të lira, nëse zyrtari ka kompetenca vendimarrëse në dhënien e këtyre lehtësirave dhe përjashtimeve ndaj shoqërisë.

2. Zyrtari publik që përfaqëson një institucion publik në zotërimin e aksioneve ose pjesëve në kapital të një shoqërie tregtare, i ndalohet që, gjatë ushtrimit të funksionit:

a) të marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, çdo përfitim financiar, ofertë apo premtim për përfitim, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet me detyrën e tij si përfaqësues;

b) të pranojë dhurata ose pjesë në kapital, në favor të tij, nga vetë shoqëria tregtare, anëtarët ose organet e saj;

c) të blejë aksione, pjesë në kapital ose pasuri të shoqërisë, që i janë ofruar apo premtuar;

ç) të përfitojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga furnizues apo klientë të shoqërisë tregtare.

3. Ndalimet dhe kufizimet e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe për personat e lidhur me zyrtarin.. Ndalimet dhe kufizimet e këtij neni nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin.

Neni 38

Kufizimi dhe ndalimi i pranimit të dhuratave dhe përfitimeve të tjera

1. Zyrtari nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, dhurata, premtime, favore ose trajtime preferenciale, për veten, për personat e lidhur me zyrtarin, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për dhuratat e zakonshme të mikëpritjes tradicionale, dhuratat me vlerë simbolike ose të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e zyrtarit.

3. Vlera e dhuratave të lejueshme, për të cilat zyrtari nuk ka detyrimin për t'i deklaruar, nuk duhet të tejkalojë, veçmas ose së bashku, kufirin vjetor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji. Nëse zyrtari ka dyshim për vlerën e dhuratës, ai njofton menjëherë eprorin ose institucionin kompetent që të kryejë vlerësimin e saj.

4. Zyrtari, të cilit i janë ofruar dhurata, premtime, favore ose trajtime preferenciale, duhet:

a) t'i refuzojë menjëherë, ose t'ia kthejë ofruesit nëse janë pranuar pa dijeninë e tij;

b) t'i raportojë menjëherë eprorit ose institucionit më të afërt epror në rast pamundësie për kthim;

c) të përpiqet të identifikojë ofruesin dhe të shmangë kontaktet e panevojshme me të;

ç) të ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, kolegët që punojnë me të;

d) të informojë menjëherë eprorin ose institucionin më të afërt epror për rrethanat e rastit dhe identitetin e ofruesit, nëse është i identifikueshëm, si dhe të japë vlerësimin e tij për lidhjen e ngjarjes me ushtrimin e funksionit zyrtar;

dh) të vazhdojë ushtrimin e funksioneve zyrtare në mënyrë të paanshme dhe të mbajë në dijeni eprorin për çdo zhvillim të mëtejshëm;

e) të raportojë rastin pranë organeve kompetente nëse dyshohet se përbën vepër penale.

5. ILDKPKI, përcakton modalitetet e administrimit të dhuratave që mund të pranohen nga zyrtari si dhe të dhuratave që nuk mund të kthehen në institucionet publike, në përputhje me përcaktimet

në legjislacionin për etikën. Institucionet publike në hartimin e rregulloreve për parandalimin e konfliktit të interesave duhet të parashikojnë rregulla të posaçme për marrjen, regjistrimin dhe trajtimin e dhuratave, premtimeve, favoreve ose trajtimeve preferenciale.

KREU VII

MËNYRAT E ZGJIDHJES DHE TRAJTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Neni 39

Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave

1. Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

- a) duke transferuar apo tjetërsuar interesat privatë;
- b) duke u vetëpërkrahuar paraprakisht nga procesi i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit të një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës ose në rastet e organit kolegjal, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt.
- c) duke dhënë dorëheqjen nga detyrat, funksionet apo angazhimet private, që janë në konflikt me funksionin e tij publik.
- ç) duke dhënë dorëheqjen nga funksioni publik, veçanërisht në kushtet e lindjes së konfliktit të vazhdueshëm të interesit.

2. Për kategoritë e zyrtarëve, të përcaktuara në nenet 25 deri 34 të këtij ligji, kur trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të vazhdueshëm të interesit nuk mund të arrihet nëpërmjet mënyrave të dhëna në pikën 1 të këtij neni, që zyrtari të vazhdojë të qëndrojë në të njëjtin funksion, duhet të:

a) heqë dorë nga funksionet drejtuese ose të anëtarësisë në organet drejtuese në çdo rast që kjo i ndalohej, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë nga çasti i lindjes së këtij detyrimi dhe të njoftojë e të dokumentojë këtë fakt menjëherë dhe jo më vonë se 10 ditë nga kryerja e tij;

b) ndërpresë sa më parë të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se brenda 30 ditëve, ushtrimin e veprimtarive të ndaluara, dhe t'u kërkojë organeve kompetente çregjistrimin sipas ligjit të këtyre veprimtarive. Zyrtari njofton dhe dokumenton përmbushjen e këtyre detyrimeve menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga afati i mësipërm, si dhe njofton dhe dokumenton çregjistrimet e kryera nga organet kompetente në çdo kohë dhe menjëherë, sapo ato të jenë kryer;

c) transferojë të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve apo të pjesëve në kapital që zotëron te personi i besuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligj dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëtitë tregtare.

3. Personi i lidhur me zyrtarin, sipas përcaktimeve në ligj, duhet të zbatojë masat e mëposhtme për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave:

- a) të transferojë ose tjetërsojë interesat privatë që krijojnë konflikt me funksionin publik të zyrtarit, brenda 30 ditëve nga momenti i identifikimit të konfliktit;

- b) të heqë dorë nga funksionet drejtuese ose anëtarësia në organet drejtuese të subjekteve që krijojnë konflikt me funksionin publik të zyrtarit, brenda 15 ditëve nga momenti i identifikimit të konfliktit;
- c) të ndërpresë, brenda 30 ditëve, ushtrimin e veprimtarive që janë në konflikt me funksionin publik të zyrtarit dhe të kërkojë çregjistrimin e këtyre veprimtarive sipas ligjit;
- ç) të transferojë të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve apo të pjesëve në kapital që zotëron te një person i besuar, brenda 30 ditëve nga momenti i identifikimit të konfliktit të interesit;
- d) të njoftojë dhe dokumentojë përmbushjen e detyrimeve të mësipërme pranë ILDKPKI-së, brenda 10 ditëve nga kryerja e tyre.

Në rast se zyrtari ose personi i lidhur nuk janë të gatshëm të zbatojnë kërkesat e mësipërme të këtij neni, atëherë zyrtari është i detyruar të japë dorëheqjen nga funksioni sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 15 ditë nga çasti i lindjes së këtij detyrimi ose nga konstatimi i tij.

4. Në raste të veçanta, kur konflikti i interesit lidhet me drejtuesin më të lartë të një institucioni publik, trajtimi dhe zgjidhja e tij bëhet nga institucioni epror, nëse ka të tillë, dhe kjo nuk çënon parimin e pavarësisë së institucioneve. Kur konflikti i interesit lidhet me një anëtar të një organi të parashikuar nga kushtetuta, trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesit bëhet nga organet kompetente të përcaktuara në Kushtetutë. Kur ligjet organike dhe Kushtetuta nuk parashikojnë institucione të tilla të cilat bëjnë të mundur trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, institucioni përgjegjës është ILDKPKI.

Neni 40

Kalimi i të drejtave të zotërimit aktiv në shoqëritë tregtare

1. Zyrtari, brenda 30 ditëve nga zgjedhja, caktimi ose emërimi në funksionin publik, duhet të bëjë kalimin e të drejtave të tij në shoqëri kur rezulton pronar i aksioneve apo kuotave në shoqëri tregtare dhe brenda afatit prej 5 ditëve nga data e kalimit të këtyre të drejtave të njoftojë me shkrim ILDKPKI mbi personin e besuar dhe dokumentin e kalimit të të drejtave të tij në shoqërinë tregtare.
2. Gjatë kohës kur të drejtat për administrim dhe drejtim të shoqërisë i janë kaluar personit të besuar, zyrtari nuk ka të drejtë të përfaqësojë biznesin, të japë informacion, udhëzime, urdhëresa apo të ushtrojë ndikim në ndonjë mënyrë tjetër, të qëndrojë në lidhje me personin e besuar, që të ketë ndikim në realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrave që dalin nga administrimi dhe drejtimi i shoqërisë.
3. Zyrtari ka të drejtë të informohet për ecurinë dhe gjendjen në shoqërinë tregtare ku ka zotërim të tërthortë të aksioneve ose pjesëve në kapital. Palët, në çdo rast, ruajnë të drejtën e zgjidhjes së marrëveshjes.
4. Zyrtari ka të drejtë të rikthejë të drejtat që lidhen me administrimin apo drejtimin e shoqërisë tregtare nga personi i besuar, kur sipas këtij ligji kushtet që diktuan këtë veprim nuk ekzistojnë më.

KREU VIII

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR PARANDALIMIN DHE ZGJIDHJEN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE DHE KOMPETENCAT E TYRE

Neni 41

Institucionet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave

1. Institucioni qendror përgjegjës për mbikqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji është Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).
 - a) Inspektoriati ka funksion verifikimi dhe hetimi fillestar, sipas kompetencave të parashikuara në ligj, i cili kryhet nga inspektorët nën drejtimin e Inspektorit të Përgjithshëm;
 - b) Inspektoriati ka funksion kontrollues në lidhje me veprimtarinë e Institucioneve Përgjegjëse në zbatimin e këtij ligji, i cili kryhet nga inspektorët nën drejtimin e Inspektorit të Përgjithshëm.
2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:
 - a) eprorët e zyrtarëve, titullari i institucionit dhe institucionit epror;
 - b) institucionet eprorë;
 - c) njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave të miratuara posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik, mbështetur në praktikën unike të zgjidhjes dhe menaxhimit të konfliktit të interesit, bazuar në kompetencën e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.
3. Institucionet, me akte të brendshme, parashikojnë dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre.

Neni 42

Kompetencat e eprorit të zyrtarit, titullarit të institucionit dhe të institucionit epror

1. Eprori direkt, titullari i institucionit ose institucioni epror merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin e interesave të çdo forme, për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësive të zyrtarit. Këto masa përfshijnë, por nuk kufizohen:
 - a) kufizimin e informacionit të caktuar për zyrtarin ose shmangien e detyrave dhe përgjegjësive që përbëjnë shkak për shfaqjen e konfliktit të interesit;
 - b) të mos lejojë që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
 - c) rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit ose transferimin në një detyrë tjetër që mënjanon konfliktin e interesave, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe me ligj;
 - ç) shmangien e emërimit ose të zgjedhjes së zyrtarit në funksione në të cilat ekzistojnë ose mund të lindin konflikte të interesave;
 - d) anulimin ose shfuqizimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit faktik të interesave, mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
 - dh) anulimin ose shfuqizimin e një akti, edhe kur çmohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
 - e) anulimi ose shfuqizimi i një akti administrativ nuk bëhet nga eprori apo institucioni epror, kur vlerësohet se pasojat që mund të vinë nga anulimi ose shfuqizimi i tejkalojnë dukshëm

përfitimet nga ky anullim apo shfuqizim. Në këtë rast eprori apo institucioni epror njofton ILDKPKI dhe Avokaturën e Shtetit, brenda 5 ditëve, nga konstatimi i rastit.

ë) eprori ose institucioni epror që konstaton lidhjen e një kontrate administrative në kushtet e konfliktit faktit të interesave, njofton brenda 5 ditëve nga konstatimi i rastit, Avokaturën e Shtetit, me qëllim ngritjen e padisë për pavlefshmërinë e saj. Në këtë rast eprori apo institucioni epror njofton edhe ILDKPKI.

2. Pavarësisht masave të mësipërme dhe çdo mase tjetër të përcaktuar me ligj, zyrtari ose eprori i tij sipas hierarkisë nuk përjashtohen nga përgjegjësia kur masat e marra nuk japin efekt në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit sipas këtij ligji.

3. Eprori direkt, titullari i institucionit ose institucioni epror njoftojnë ILDKPKI për masat e marra, brenda 5 ditëve nga marrja e masave për zgjidhjen e konfliktit të interesit.

4. Kur një akt i një institucioni publik bëhet i pavlefshëm sipas përcaktimeve në ligj:

a) Institucioni publik kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim, brenda 30 ditëve nga njoftimi ndërmerr:

i-procedurat e ecuresë disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës;

ii-përdor mjete ligjore për kalimin e barrës së dëmshpërblimit tek zyrtari përgjegjës;

iii-i kërkon gjykatës edhe dëmshpërblim moral në favor të institucionit për dëmin moral;

iv-bën kallëzim penal nëse gjykon se shkelja është vepër penale.

Përcaktimet e gërmës “a” të kësaj pike zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari përgjegjës i cili nuk ka parandaluar konfliktin e interesit shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatim të detyrimeve, sipas gërmës “a” të kësaj pike.

b) Në rastin e deputetit zbatohet procedura dhe masat e parashikuar nga Rregullorja e Kuvendit dhe Kodi i Sjelljes së Deputetit. Në rastin e gjyqtarit për vendimet gjyqsore të marra prej tij ose për votën e tij në një vendim gjyqsor, nuk zbatohet gërma “ii” dhe “iii”. Në rastin e prokurorit në ushtrimin e detyrës dhe zyrtarë të tjerë që ushtrojnë funksione kontrolli, nuk zbatohet gërma “ii” dhe “iii”.

Neni 43

Kompetencat e njësisë përgjegjëse të parandalimit të konfliktit të interesave në institucionet publike

1. Njësia përgjegjëse e parandalimit të konfliktit të interesave në Institucionet Publike ka këto kompetenca:

a) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të deklarimeve të interesave private për zyrtarin publik që mbart detyrimin për deklarim pranë njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në lidhje me zbatimin e kufizimeve dhe ndalimeve të interesave private për konfliktin e vazhdueshëm, të mundshëm dhe rast për rast të interesit;

b) verifikon dhe kryhen hetimin administrativ për konfliktin rast për rast të interesave private të zyrtarëve kur ata përfshihen në vendimmarrje për veprime administrative, sipas fushës së zbatimit të ligjit;

c) mbledh dhe pranon nga burime të ligjshme informacion për interesat privatë të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informacionet e ofruara nga media dhe çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi;

ç) verifikon besueshmërinë e burimeve dhe informacionit për të vërtetuar konfliktin e interesit;

d) vë në dijeni zyrtarin për informacionin e siguruar për të dhe që përbën shkak për konflikt interesi, dhe i jep mundësi të provojë të kundërtën;

dh) njofton me shkrim personin fizik ose juridik dhënë të informacionit brenda afatit prej 30 ditësh për shqyrtimin e informacionit të dhënë dhe vendimet e marra.

e) njofton me shkrim eprorin e institucionit publik dhe ILDKPKI në lidhje me zyrtarët publikë, që do të rezultojnë se posedojnë interesa private në kundërshtim me kufizimet dhe ndalimet e vendosura në ligj, brenda afatit 30 ditor nga përfundimi i verifikimeve të kryera.

ë) njofton me shkrim eprorin e institucionit publik dhe ILDKPKI në lidhje me zyrtarët publikë, që do të rezultojnë me vendimmarrje për veprime administrative të marra në prani të interesave private, brenda afatit 30 ditor nga përfundimi i verifikimeve të kryera.

f) kryen regjistrimin e interesave privatë të zyrtarëve publikë dhe ndryshimeve në to;

g) kryen regjistrimin e çdo rasti të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, në regjistrat e konfliktit të interesit, të cilat miratohen sipas modelit të përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

2. Në përshkrimin e pozicionit të punës të njësisë përgjegjëse për parandalimin e e konfliktit të interesave, vendosen kriteret dhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të të punësuarve në njësinë përgjegjëse të parandalimit të konfliktit të interesave në institucionet publike, njoftohet paraprakisht ILDKPKI.

3. Njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave i dorëzon ILDKPKI-së çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe statusin e trajtimit të tyre.

4. Njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, për veprimtarinë verifikuese të parashikuar në këtë dispozitë, ushtron kontroll brenda 6 muajve nga dorëzimi i deklaratës së konfliktit të interesave ose brenda 6 muajve nga konstatimi i çështjes me konflikt interesi.

5. Njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, mbledh dhe i dërgon Inspektoriatit të Lartë, deklaratat e plotësuara të interesave privatë para fillimit të detyrës, pas largimit nga funksioni, brenda 15 ditëve nga përmbushja e afatit ligjor për dorëzimin e këtyre deklaratave nga subjekti deklarues. Deklaratat periodike vjetore i dërgohen Inspektoratit të Lartë, brenda datës 15 prill të çdo viti. Autoritetet përgjegjëse njoftojnë ILDKPKI për rastet e mosdeklarimeve.

Neni 44

Kompetencat e ILDKPKI-së

1. ILDKPKI, me cilësinë e Institucionit qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, ka këto kompetenca:

a) kryen drejtimin dhe përmirësimin e politikave dhe të mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave dhe monitoron zbatimin e tyre;

b) ofron ndihmë teknike dhe profesionale për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore, të ndërmarra nga institucionet publike, për parandalimin e konfliktit të interesave;

c) ofron rekomandime për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për vlerësimin e projektligjeve që kanë të bëjnë me çështjen e konfliktit të interesave, kur kërkohet nga ky institucion;

ç) ndihmon në forcimin e kapaciteteve për trajtimin e konfliktit të interesave në institucione dhe merr masa për trajnimin e tyre;

d) monitoron, kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e akteve nënligjore dhe të rregulloreve të brendshme, të miratuara nga institucionet publike për konfliktin e interesave, me parimet dhe detyrimet e këtij ligji;

dh) monitoron, kontrollon dhe vlerëson zbatimin e këtij ligji, në tërësi, për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, si dhe të respektimit të këtij ligji, në raste të veçanta të konfliktit të interesave;

e) realizon regjistrimin periodik të interesave privatë të zyrtarëve deklarues;

ë) përcakton modelin e Deklarimit të Konfliktit të interesave private dhe të autorizimit për kontroll, si dhe të regjistrimit të zyrtarëve publikë për regjistrimin e të dhënave që lidhen me konfliktin e interesit;

f) këshillon zyrtarët, eprorët, institucionet eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave të lidhura me ta, si dhe për regjistrimin periodik dhe rast për rast të interesave, pasi janë shteruar më parë mjetet e brendshme në institucionet publike ose kur gjykohet e nevojshme nga ILDKPKI;

g) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të deklarimeve të interesave private për zyrtarët që kanë detyrimin të deklarojnë në ILDKPKI;

gj) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të kufizimeve të interesave private për konfliktin e vazhdueshëm për raste dhe çështje të veçanta të vendosura për zyrtarët që kanë detyrimin të deklarojnë në ILDKPKI;

h) njofton institucionin epror, si dhe Avokaturën e Shtetit për të vazhduar procedurat e mëtejshme ligjore në lidhje me anulimin dhe shpalljen e pavlefshmërisë të veprimeve administrative me konflikt interesi, si dhe për rregullimin e pasojave ligjore të shkaktuara prej tyre, të cilat rezultojnë pas kontrollit dhe hetimit administrativ të zyrtarit;

i) monitoron, kontrollon dhe vlerëson zbatimin e këtij ligji nga njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, lidhur me rastet e shfaqjes të formave të konfliktit të interesit të përcaktuara në këtë ligj;

j) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve dhe kufizimeve të interesave të përcaktuara në këtë ligj, për zyrtarët, kur e gjykon të nevojshme me nismën e saj ose i kërkon institucioneve përgjegjëse pranë institucionit publik për të kryer verifikimin dhe hetimin e rastit;

k) ndërmerr dhe ndjek veprimet për pavlefshmërinë dhe korigjimin e veprimeve administrative në institucionet publike kompetente, me qëllim rregullimin e pasojave ligjore, për veprime administrative të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesit, me kërkesën e palëve të interesuara ose me nismën e saj;

l) vendos masa administrative ndëshkuese në kompetencë të saj, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

2. ILDKPKI administron, përditëson dhe mirëmban regjistrin e zyrtarëve publikë sipas përcaktimeve të këtij ligji. Të dhënat në këtë Regjistër bëhen publike, në masën dhe përsa përcaktohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi.

3. Për verifikimin dhe hetimin administrativ të Deklarimit të Konfliktit të Interesave, ILDKPKI ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e nevojshme në të gjithë administratën shtetërore dhe publike dhe

tek personat juridikë publikë e privatë, të cilët detyrohen të venë në dispozicion të dhënat e kërkuara nga ILDKPKI, jo më vonë se 15 ditë pas paraqitjes së kërkesës.

4. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, në zbatim të përgjegjësisë dhe kompetencave në këtë ligj, nxjerr urdhra, udhëzime dhe akte të tjera administrative, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

5. Mbi bazën e raportit vjetor, Inspektori i Përgjithshëm harton vlerësime dhe rekomandime lidhur me zbatimin e këtij ligji nga njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit në institucionet publike.

6. Institucionet publike, gjatë veprimtarisë administrative, kur vihen në dijeni të veprimeve të kryera nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, për të cilin ligji ka vendosur kufizime dhe ndalime në lidhje me pronën publike, detyrohen të pezullojnë procedurat ligjore dhe të njoftojnë për këtë fakt, brenda 5 ditëve institucionin publik ku punon zyrtari dhe ILDKPKI-në.

KREU IX

PROCEDURA ADMINISTRATIVE PËR VERIFIKIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT DHE PËR RREGULLIMIN E PASOJAVE TË SHKAKTUARA NGA KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 45

Procedura administrative nga Institucionet Përgjegjëse, për verifikimin e konfliktit të interesit dhe për rregullimin e pasojave të shkaktuara nga konflikti i interesave

1. Procedura administrative për verifikimin e konfliktit të interesit dhe për rregullimin e pasojave të shkaktuara nga konflikti i interesit fillon:

- a) me kërkesën e zyrtarit;
- b) *ex-officio* respektivisht nga ILDKPKI dhe Institucionet Përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji;
- c) në bazë të informacionit të marrë paraprakisht, përfshirë informacionin anonim;
- ç) në rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi .

2. Procedura hetimore administrative e zhvilluar nga ILDKPKI dhe institucionet publike përgjegjëse për verifikimin e konfliktit të interesit dhe për rregullimin e pasojave të shkaktuara nga konflikti i interesit, mbështetet në Kodin e Procedurave Administrative dhe në këtë ligj, dhe është konfidenciale.

3. Institucionet përgjegjëse në bazë të kompetencave të dhëna nga ky ligj kur marrin dijeni për konfliktin e mundshëm të interesit, fillojnë menjëherë procedurën hetimore administrative për verifikimin dhe vërtetimin e konfliktit të mundshëm të interesit dhe rregullimin e pasojave të shkaktuara prej tij.

4. Procedura hetimore administrative për zyrtarët dhe që lidhet me konfliktin e vazhdueshëm të interesit dhe të çështjeve të veçanta kryhet nga ILDKPKI apo nga institucionet publike përgjegjëse, përjashtuar rastet kur me ligji është parashikuar ndryshe dhe që lidhet me disa funksione dhe procese ligjore, sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj.

5. Procedura hetimore administrative në rastet e zyrtarëve për konfliktin rast për rast dhe që lidhet me një vendimmarrje, kryhet nga institucionet përgjegjëse në institucionin publik, sipas parashikimeve të bëra në ligj.

6. Procedura hetimore administrative për verifikimin dhe vërtetimin e veprimeve administrative të kryera që mund të sjellin ekzistencën e konfliktit të interesit, kryhet nga insitucionet publike pranë të cilit është i punësuar zyrtari, ose nga institucione të tjera publike që verifikojnë apo kontrollojnë këto veprime administrative sipas legjislacionit në fuqi. Institucioni publik që kryen hetimin administrativ, anulon ose shfuqizon veprimet administrative të kryera në mënyrë të arsyetuar, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative.

7. Procedura hetimore administrative për rregullimin e pasojave juridike të veprimeve administrative të marra në kushtet e konfliktit të interesit kryhet nga insitucioni publik pranë të cilit është i punësuar zyrtari përgjegjës ose nga institucione të tjera publike që verifikojnë apo kontrollojnë këto veprime administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Institucioni publik dhe Avokatura e Shtetit për rregullimin e pasojave juridike të shkaktuara prej veprimeve administrative të lidhura në kushtet e konfliktit të interesit, kur nuk gjen zgjidhje me mjetet ligjore, i drejtohet institucioneve të ngarkuara nga ligji, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës ligjore.

Për veprimet e kryera njoftohet zyrtarisht me shkrim ILDKPKI, brenda 15 ditëve nga kryerja e veprimit të fundit hetimor-administrativ së bashku me një vlerësim përfundimtar për masën administrative që vlerësohet se duhet të aplikohet.

8. ILDKPKI, në rastet e procedurave hetimore administrative sipas pikës 7 të këtij neni, verifikon dhe bën vlerësimin përfundimtar të procedurës hetimore administrative të kryer në bazë të këtij ligji dhe vendos lidhur me llojin e masës administrative që duhet zbatuar.

ILDKPKI, nëse konstaton se janë shkelur procedurat dhe nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore administrative sipas këtij ligji, dhe për rrjedhojë kjo ka çuar në pamundësinë e marrjes së një vendimi përfundimtar, e kthen për riverifikim çështjen duke vendosur detyrat përkatëse të cilat përmbushen brenda afateve të parashikuara në këtë ligj.

9. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimimi ndaj tyre, rregullohen sipas këtij ligji dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 46

Procedurat ligjore të veçanta për disa zyrtarë dhe procese ligjore

1. Kompetencat e eprrorëve ose të institucioneve eprore për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit, përfshirë ndalimet ose kufizimet, sipas këtij ligji, zgjidhja e të cilave bëhet sipas mënyrave të dhëna në nenet 35, 38, 39, 40 dhe 41 të këtij ligji dhe procedurat për ushtrimin e këtyre kompetencave përcaktohen nga:

a) Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale, respektivisht për proceset gjyqësore civile dhe procedimet penale;

b) Kodi i Procedurave Administrative për të gjitha institucionet publike, që i nënshtrohen këtij Kodi;

c) ligje të veçanta, që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike ose të drejtat dhe detyrimet e kategorive të ndryshme të zyrtarëve;

ç) Kushtetuta, kur konflikti lidhet me një zyrtar, që njësohet ose është anëtar i një organi kushtetues.

2. Procedurat dhe kompetencat, e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, përcaktojnë edhe mënyrën se si vetë zyrtari ose personi i lidhur me të, ndaj të cilit janë zbatuar masat për trajtimin

dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit, mund të ankohe kur e gjykon se këto masa janë marrë në tejkalim të përcaktimeve të këtij ligji.

3. Për Presidentin e Republikës nuk gjejnë zbatim përcaktimet për konfliktin rast për rast të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ai ushtron funksionet si anëtar i një organi kolegjial, si dhe kur kjo ka të bëjë me një proces gjyqësor ndaj tij.

4. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas fushës së veprimit të këtij ligji, bëhet vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar.

KREU X

SANKSIONET

Neni 47

Kundërvajtjet administrative

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet me gjobë si vijon:
 - a) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 21, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - b) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 22, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë
 - c) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuar në pikën 1, 2 dhe 3 të nenit 23, zyrtari dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - ç) Për shkelje të detyrimit të përcaktuar në pikën 4 të nenit 23, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë.
 - d) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 24, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - dh) Për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenet 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32 dhe 33, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - e) Për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 34, zyrtari, personi i lidhur, personi i besuar, drejtuesi i shoqërisë, dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - ë) Për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenit 36 zyrtari, ose personi i lidhur, personi i besuar, drejtuesi i shoqërisë, lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - f) Për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 37, zyrtari, personi i lidhur, personi i besuar, drejtuesi i shoqërisë, dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - g) Për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 38 zyrtari dhe/ose personi i lidhur, dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - gj) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 35, zyrtari dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.

- h) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 35, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohet me gjobë nga 200 000 lekë deri në 500 000 lekë.
 - i) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 39, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - j) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 40, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - k) Për shkelje të detyrimit në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme të përcaktuara në nenin 42, eprori i zyrtarit dhe/ose institucionit epror dhe/ose titullari i institucionit, dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - ll) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 43, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë.
 - m) Kur nuk jepen pa arsye dhe në afatin e caktuar të dhënat e kërkuara nga ILDKPKI, sipas nenit 44 pika 2, personat përgjegjës të institucioneve dhe personave juridikë publikë dhe privatë dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë.
 - n) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikën 8 të nenit 45, titullari i institucionit dhe/ose njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë.
 - nj) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 49, titullari i institucionit dhe/ose njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë.
 - o) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 50, zyrtari publik dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë.
2. Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm e të konstatuara gjatë veprimtarisë kontrolluese të ILDKPI, dhe që nuk janë pasqyruar në pikën 1 të kësaj dispozite Inspektori i Përgjithshëm dënon personat përgjegjës me gjobë në masën nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë”.
3. Gjjobat vendosen nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI në rast se shkelja e tyre verifikohet drejpërsëdrejti prej këtij institucioni ose me propozimin e autoritetit përgjegjës në institucione për çështjet e konfliktit të interesave, apo të shkeljes së detyrimeve pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.
4. Modalitetet dhe procedura e bashkëpunimit mes ILDKPKI dhe autoriteteve përgjegjëse në institucione për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me udhëzim të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI.
5. Gjjobat paguhen nga kundërvajtësi dhe derdhen në buxhetin e ILDKPKI, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës. Me kalimin e këtij afati gjoba përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune ose nga zyra e përmbarimit me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI.
6. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimimin ndaj tyre, rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
7. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve apo hetimit administrativ të ILDKPKI, bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes, bazuar edhe në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 48

Përgjegjësitë e tjera ligjore

1. Deklarata për konfliktin e interesit dhe të gjithë dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja e të dhënave të rreme përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit penal në fuqi.
2. Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësiave eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit ose statusin e zyrtarëve. Institucioni publik që fillon procedurën disiplinore, sipas këtij ligji, duhet ta njoftojnë ILDKPKI për të dhe për rezultatin në përfundim të saj.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për shkeljen e kryera nga anëtarët e njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike sipas nenit 38 të këtij ligji, i propozon titullarit të institucionit ose institucionit epror dhënien e masës disiplinore sipas legjislacionit përkatës ose largimin nga funksioni të këtij anëtari.
4. Dispozitat e këtij ligji nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
5. ILDKPKI, çdo zyrtar, epror direkt i zyrtarit ose institucioni epror paraqesin kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarit i cili shkel detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, dhe që përbëjnë veprë penale sipas Kodit Penal, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49

Aktet nënligjore

1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, brenda 6 muajve nga miratimi i ligjit, miraton aktet nënligjore në zbatim të pikës 3 dhe 4 të nenit 21, si dhe nenit 44 të këtij ligji.
2. Titullarët e institucioneve, me propozim të njësisë përgjegjëse të parandalimit të konfliktit të interesave, miratojnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, Rregulloren për parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesit, përfshirë edhe institucionet nën varësinë e tyre.
3. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij neni publikohen përkatësisht në faqen e zyrtare të ILDKPKI-së dhe institucioneve përgjegjëse.

Neni 50

Deklarimi i konfliktit të interesave nga zyrtarët me hyrjen në fuqi të ligjit.

Zyrtarët publikë plotësojnë formularin e Deklarimit të Interesave Private dhe e depozitojnë atë në ILDKPKI apo njësinë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, brenda 30 ditëve nga miratimi i formës dhe përmbajtjes së tyre nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Neni 51
Shfuqizim

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 52
Dispozita tranzitore

1. Të gjitha procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të trajtohen dhe do të zgjidhen në bazë të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
2. Të gjitha procedurat e regjistruara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që i referohen situatave para hyrjes në fuqi të tij, do të trajtohen në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 53
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në 6 muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Elisa Spiropali